



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 5239 Prot.

Tiranë më, 01/03/2019

**FTESË PËR OFERTË**

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është në fazën e Ankandit Publik të formës “procedurë me përzgjedhje të blerësve” me objekt **“Përzgjedhja e institucionit financiar, që do të kryejë shërbimin e mbajtjes së llogarive dhe transferimin e pagesave”**.

Ju lutemi kërkojmë të na vini në dispozicion: ofertën Tuaj sipas kritereve të përcaktuara si më poshtë:

**KRITERET**

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor është institucion shtetëror me vetëfinancim me qëndër në Tiranë e cila operon në 14 Drejtori Rajonale në rrethe si të listuara si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me adrese: Rr Muhedin Llagani Nr.10, Tiranë.
2. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë me adresë:
  - a) Autostrada Tiranë – Durrës, Km i 7 Kashar Tiranë
  - b) QKT ish NSHRAK Tiranë
  - c) QKT Prezë Tiranë.
3. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës me adrese: Shkozet dhe Kavajë.
4. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Fier me adresë: a) Fier dhe Lushnjë
5. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Vlorë me adresë: Vlorë dhe Himarë
6. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastrë me adresë: Gjirokastrë.
7. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Sarandë me adresë: Vrion Sarandë.



Adresa: Rr. “Muhedin Llagani”, Nr.10, Tiranë; Tel.: +355 68 801 5 833 Fax.: +355(0)4  
2238175e-mail: dpshttr@dpshttr.gov.al www.dpshttr.gov.al

8. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë me adresë: Korçë dhe Pogradec.
9. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat me adresë: Berat dhe Çorovodë.
10. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Elbasan me adresë: Elbasan dhe Gramsh.
11. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër me adresë: Shkodër.
12. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Laç me adresë: Laç dhe Lezhë
13. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Kukës me adresë : Kukës dhe Tropojë.
14. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Peshkopi me adresë: Peshkopi dhe Burrel
15. Drejtoria e Targave dhe e Shtypshkrimeve me adresë: Durrës

Qarkullimi vjetor i parasë arrin mbi 7 miliardë lekë në vit.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor aktivitet kryesor ka shërbimet ndaj qytetarëve për pajisjen me Leje Drejtimi si dhe Regjistrimin e Mjeteve. DPSHTRr është dhe agjent i Taksës Vjetore të Mjeteve të Përdorura si dhe Taksës së Mjeteve të Luksit. Veprimtaria e saj ka një shtrirje në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka sportelet e veta në adresat e lart përmendura.

**Komisioni ka përgatitur kriteret për kualifikimin e përzgjedhjes së Institucionit Financiar për kryerjen e shërbimit të mbajtjes së llogarive dhe transferimin e pagesave si më poshtë:**

- a) Komision minimal deri në vlerën 0 All, për transaksionin e transferimit të pagesave të pagave të individëve, si dhe të pagesave të tjera të lidhura me aktivitetin, në bankat e kërkuara.
  - b) Komision minimal deri në vlerën 0 All, për mirëmbajtje llogarie të pagave e të pagesave të tjera, të lidhura me punën për individët që i kanë llogaritë e pagave në të njëjtin institucion financiar me atë në të cilin mbahen llogaritë e vetë institucionit.
- \*Hapje dhe mirëmbajtje llogarie 0 All komision.
  - \*Transfertat brenda Bankës në çdo degë 0 All komision.
  - \*Hapje llogarie Internet Banking 0 All komision
  - \*Pagesa faturash në Internet Banking për të paguar këto fatura 0 All komision.
  - \*Printim i ekstraktit të llogarisë personale në çdo kohë apo degë 0 All komision.
  - \*Printim dhe mirëmbajtje karte 0 All komision.
  - \*Karta e debitit mund të lidhet me më shumë se 4 llogari.
  - \*Karta me afat përdorimi mbi 4 vjeçar.



- \*Riprintim automatik pas 4 vjetesh 0 **All** komision.
- \*Deri në 3 paga neto Overdraft.Me % më minimale për pagamarrësit.
- \*Komision mirëmbajtje 0 **All**.
- \*Transfertë për mbyllje overdraft në bankë tjetër pa komision.
- \*Printim i 5 veprimeve të fundit të ATM 0 **All** komision.
- \*Printim i faturës në moment tërheqje 0 **All** komision.
- \*Ndryshim PIN në ATM i kartave 0 **All** komision
- \*Aplikim për Karta shtesë 0 **All** komision.
- \*Call Center 24h / 7 ditë e javës.
- \*Arkëtim i Cash-it në sportele në të gjitha degët e bankave nga e hëna në të premte në oraret 8.30-15.30.
- \*Institucioni Financiar i përzgjedhur duhet të marrë përsipër depozitimin e cash-it në pikën pranë Kasha Tiranë, nga e hëna në të premte në oraret 8.30-16.15 dhe për ditë të shtunë ora 8.00-14.00.
- \*Institucioni Financiar i përzgjedhur duhet të marrë përsipër depozitimin e cash-it në pikën Prezë Tiranë, nga e hëna në të premte në oraret 8.30-16.15 dhe për ditë të shtunë ora 8.00-14.00.
- \*Arkëtime përmes POS fizik dhe virtual me 0 **ALL** komision.
- \*Depozitimin e Cash-it dhe në ditët e pushimit për Bankat.
- \*Ofrim i shërbimit për depozitimin e parave me Drop box.
- \*Mirëmbajtja e llogarisë (Mujore) 0 **ALL** komision.
- \*Njoftim për gjendjen dhe lëvizjet e llogarisë(Mujore) 0 **ALL** komision.
- \* në sportelet e bankës (me pak se 1 vit) 0 **ALL** komision.
- \* në sportelet e bankës (me shume se 1 vit) 0 **ALL** komision.
- \* dërguar me e-mail 0 **ALL** komision.
- \* dërguar me postë 0 **ALL** komision.
- \* Mbyllja e Llogarisë 0 **ALL** komision.
- \* Kosto 0 **ALL** për arkëtime dhe pagesa brenda bankës.
- \* Kosto minimale për transaksion me veprimet me bankat e tjera.
- \* Kosto 0 **ALL** për pagesa me tatimet dhe taksat.
- \* Interes maksimal për llogari depozitë me dhe pa afat.
- \* Interes maksimal për llogari rrjedhëse në ALL, EUR,USD.
- \* Shpejtësi në kryerjen e depozitimit të të ardhurave të përmendura në shkronjat më lart.
- \* Shpejtësi dhe cilësi në kryerjen e transaksioneve nga llogaritë e punonjësve publikë.
- \*Cilësi shërbimi përsa i përket transparencës me subjektet të cilat përdorin sportelet e institucionit financiar.
- \* Shpejtësi në dhënien e informacionit për mbajtësin e llogarisë sa herë që kjo të kërkohet nga ky i fundit.
- \*Institucioni financiar i përzgjedhur të ketë shtrirje sa më të madhe në adresat e lartpërmendura.



Bashkëlidhur ofertës Tuaj duhet të dorëzoni dhe kopje të noterizuar të:

**LICENCËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.**

Afati kohor për dorëzimin e ofertave skadon më **15.03.2019 (dd/mm/vv) ora 10:00**. Ofertat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor do t'i rikthehen të pahapura Kandidatëve pjesëmarrës.

**Vendi i Dorëzimit: Në formë shkresore pranë DPSHTRR Tiranë, me adresë: Rr Muhedin Llagani Nr.10 Tiranë.**

Hapja publike e ofertave do të kryhet më **15.03.2019(dd/mm/vv) në orën 10:00**, në zyrat e DPSHTRR-së.

Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të jenë të paisur me Autorizim përkatës të përfaqësimi të cilët duhet të jenë të pranishëm në hapjen e ofertave.

Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave duhet t'i komunikohet të gjithë Kandidatëve pjesëmarrës të pranishëm.

**Kandidatët blerës duhet të dorëzojnë vetëm ofertën origjinale të futur në një zarf jotransparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Ofertuesit dhe të shënuar:**

**“Ofertë për Përzgjedhjen e institucionit financiar, që do të kryejë shërbimin e mbajtjes së llogarive dhe transferimin e pagesave. “Mos e hapni ofertën, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i përzgjedhjes së institucionit financiar, dhe jo para 15.03.2019 (dd/mm/vv) ora 10:00”.**

**Blendi GONXHJA**  
**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

